

VENDIM
Nr. 706, datë 12.10.2016

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT DHE TË LETËRNJOFTIMIT ELEKTRONIK PËR TË HUAJT ME STATUSIN “MBROJTJE PLOTËSUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 84, të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Modeli i dokumentit të udhëtimit dhe i letërnjoftimit elektronik për të huajt, që kanë përfituar statusin “Mbrotjtje plotësuese”, është i njëjtë me modelin e dokumentit të udhëtimit dhe të letërnjoftimit për refugjatët, të parashikuar në kontratën koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të “Sagem Securite” e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, të ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.7.2008, të ndryshuar.

2. Miratimin e specifikimeve teknike të letërnjoftimit elektronik për të huajt, që kanë përfituar statusin “Mbrotjtje plotësuese”, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Miratimin e specifikimeve teknike të dokumentit të udhëtimit për të huajt, që kanë përfituar statusin “Mbrotjtje plotësuese”, sipas aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

ANEKSI NR. 1

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DOKUMENTIT LETËRNJOFTIM PËR TË HUAJT ME STATUSIN “MBROJTJE PLOTËSUESE” NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

- Letërnjoftimi për të huajt, që kanë përfituar statusin “Mbrotjtje plotësuese” në Republikën e Shqipërisë, është i njëjtë me atë të shtetasve që kanë përfituar statusin e “refugjatit” në Republikën e Shqipërisë.

- Elementet e sigurisë janë të njëjta me elementet e sigurisë të letërnjoftimit për shtetasit shqiptarë.

- Përmasat janë të njëjta me ato të letërnjoftimit për shtetasit shqiptarë:

- Gjerësia, minimumi 85.47 mm dhe maksimumi 85.72 mm;

- Lartësia minimumi 53.93 mm dhe maksimumi 54.04 mm;

- Rrezja e qosheve minimumi 2.88 mm dhe maksimumi 3.48 mm.

- Të gjitha të dhënat personale, si: portreti, firma, imazhi i sfumuar dhe të dhënat alfanumerike janë të shtypura me anë të teknologjisë së gdhendjes me lazer.

- Në anën e përparme të dokumentit, sipër fotografisë së aplikuesit, shkruhet me ngjyrë të bardhë mbi një sfond blu, në gjuhën shqipe: ID “LETËRNJOFTIM PËR TË HUAJT” dhe në krah ka emblemën e Republikës së Shqipërisë.

- Në krah të emblemës, në pjesën ballore, shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA”.

- Autoriteti lëshues është MPB-ja (Ministria e Punëve të Brendshme).

- Letërnjoftimi ka dy cipa, atë të dukshmen me sy të lirë dhe atë të padukshmen.
- Në anën e pasme është e shtypur MRZ- zona e lexueshme nga makina, në format me tre rreshta sipas standardeve ICAO. MRZ-ja do të fillojë me shkronjat IF (F- foreigner- i huaj).

ANEKSI NR. 2

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT PËR TË HUAJT ME STATUSIN “MBROJTJE PLOTËSUESE” NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

- Dokumenti i udhëtimit për të huajt me statusin “Mbrotjtje plotësuese” ka përmasat 125x88 mm, me qoshe të rumbullakosura. Ai përmban 50 faqe, përjashtuar kapakët.
- Kapaku i dokumentit të udhëtimit/*Travel Document*, është blu e errët, me dy viza të verdha, lart në anën e majtë.
- Ngjyra e shkronjave të shtypura në kapak është flori i petëzuar.
- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e sipërme të tij, shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “REPUBLIKA E SHQIPËRISË/REPUBLIC OF ALBANIA”.
- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e mesit, vendoset emblema e Republikës së Shqipërisë.
- Në faqen ballore të kapakut, në pjesën e poshtme, shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “DOKUMENT UDHËTIMI (Konventa e 28 korrikut 1951)/TRAVEL DOCUMENT (28 July 1951 Convention). Ky shënim gjendet edhe në faqen e përparme të fletës së të dhënave.
- Në anën e brendshme të kapakut shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “Qeveria e Republikës së Shqipërisë u kërkon autoriteteve ku paraqitet mbajtësi i kësaj pasaporte t’i sigurojë ndihmë dhe mbrotjtje për të cilën mund të ketë nevojë/*The government of the Republic of Albania hereby requests the authorities where the bearer of the present passport is present, to afford the bearer every assistance and protection as may be necessary*”.
- Në anën e brendshme të kapakut, poshtë mbishkrimit të mësipërm, vendoset simboli i shqiponjës.
- Faqja e të dhënave përbëhet nga material polikarbonat. Të gjitha të dhënat personale: si portreti, firma, imazhi i sfumuar dhe të dhënat alfanumerike shtypen nëpërmjet teknologjisë së gdhendjes me lazer.
- Në faqen e të dhënave, mbi fotografinë e aplikuesit, shkruhet me shkronja ngjyrë të bardhë, mbi sfond blu, në gjuhën shqipe dhe angleze: “DOKUMENT UDHËTIMI /TRAVEL DOCUMENT”.
- Tipi i dokumentit do të jetë PR autoriteti lëshues MPB-ja (Ministria e Punëve të Brendshme) dhe fillimi i zonës së lexueshme nga makina (MRZ) do të fillojë me PR.

Shënim:

- Dokumenti i udhëtimit për personat me statusin “Mbrotjtje plotësuese”, në pjesët dhe elementet e tjera të sigurisë është i njëjtë me dokumentin e udhëtimit për shtetasit e huaj që kanë fituar statusin e “Refugjatit” në Republikën e Shqipërisë.